



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e74-të, të mbajtur më 05.09.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-530/1 datë 01.02.2022, NDËRPRITET KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Lënda me numër 12-530 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-530/1 të datës 01.02.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncimi referohen dyshimeve për emërim të paligjshëm të zyrtarit Prof. Dr. /// për Rektorin e Universitetit "///" në Shkup. Bëhet me dije se zyrtari i lartpërmendur ka qenë edhe me kohë të plotë në ///, ndërsa ka kryer edhe funksionin e rektorit të universitetit të lartpërmendur. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja kërkoi veprim kompetent nga Inspektorati Shtetëror Arsimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të RMV-së, nga ku mori përgjigje se, pas kontrollit të jashtëzakonshëm, për kushtet e konstatuara, d.m.th. parregullsitë, janë ndërmarrë veprime inspektuese për tejkalimin e tyre. Pas skadimit të afateve për zbatimin e veprimeve inspektuese, është kryer inspektimi kontrollues, gjatë të cilit është konstatuar se janë tejkaluar kushtet – me vendim të Senatit nr. /// nga /// vit, një zyrtar tjetër u zgjodh rektor.

Në bazë të këtij konstatimi, KSHPK-ja ka konstatuar se rrethanat e rastit në fjalë janë tejkaluar, nga ku ka konstatuar se lënda nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

